



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 2276 / prot.
17

Pogradec, më 22, 05, 2024

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

Znj. Manjola KAMOLLI
KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

I nderuar zoti Kryetar,
Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues, për:

“PER MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PËRZGJEDHJEN E PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I STREHIMIT SOCIAL “SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË”.

Me respekt,

KRYETARI

Ilir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 1

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 1

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më ____ . ____ .2024

PROJEKT-VENDIM

NR. _____, DATË ____ . ____ .2024

“PER MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PËRZGJEDHJEN E PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I STREHIMIT SOCIAL “SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË”.

Ne mbështetje të Ligjit Nr. 22/2018 “PËR STREHIMIN SOCIAL“ përkatësisht: Nenit 2, pika: 13,14,15,20,25,27,44,49, 51; Neni 3, pika 3 ; Neni 40,41,42,43 “Subvencionim i Interesave Të Kredisë”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI :

1. Miratimin për sistemin e pikezimit mbi projektin “Subvencionim i Interesave Të Kredisë”.

SISTEMI I PIKËZIMIT PËR TRAJTIMIN SIPAS PROGRAMIT “SUBVENCIONI I INTERESAVE TË KREDISË”		
NR.	KRITERET E PIKËZIMIT	PIKËT
A	KUSHTET E STREHIMIT	25
i	Nuk disponojnë banesë në pronësi	6
ii	Kanë ngelur të pastrehë si rezultat i fatkeqësive natyrore ose zbatimit të një vendimi gjyqësor.	5
iii	Banesa në rrezik shembje sipas përcaktimeve ligjore dhe rrezikojnë të ngelen të pastrehë.	5
iv	Banojnë në banesa të mbipopulluara sipas përcaktimeve dhe normave në fuqi.	4
v	Banojnë në banesa që prishen ose përjashtohen nga procesi i legalizimit si rezultat i investimeve publike.	5
B	KUSHTET FAMILJARE	25
i	Familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë,ku përfshihen edhe vajzat nëna.	5
ii	Të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për t’u strehuar në institucionet publike të përkujdesjes shoqërore.	0
iii	Familjet me më shumë se 4 (katër) fëmijë.	5

iv	Familjet e reja, ku moshja e anëtarit më të madh të familjes në momentin e kërkesës të jetë më e vogël ose baraz me 40 vjeç.	8
v	Të rinj, që në momentin e aplikimit kanë moshë jo më të madhe se 40 vjeç.	7
C	KUSHTET SOCIALE	25
i	Personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me përcaktimet e bëra me vendim të Këshillit të Ministrave për këto kategori dhe me shërbime kujdestarie.	4
ii	Individë më statusin e jetimit, që nga çasti i daljes nga qendrat e përkujdesjes shoqërore e deri në moshën 30 vjeç.	2
iii	Familjet e mbetura të pastreha për shkak të lirimit të banesave ish-pronarëve.	0
iv	Emigrantë të rikthyer, punëtorët emigrantë dhe azilkërkuesit, refugjatët apo personat me mbrojtje plotësuese.	2
v	Familjet e policëve të rënë në detyrë.	0
vi,	Punonjës i reparteve të ndërhyrjes së shpejtë FNSH	3
vii,	Punonjësit e repartit RENE A	
viii	Punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit	
ix	Viktimat e trafikimit / Viktimat e mundshme të trafikimit	3
x	Anëtarët e komunitetit Rom dhe Egjiptian	4
xi	Të miturit në konflikt me ligjin, sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, pas ekzekutimit të dënimit.	2
xii	Vajzat Nëna.	3
xiii	Individët që i përkasin komuniteti LGBTI, të cilët janë viktimat për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor	2
D	KUSHTET EKONOMIKE	25
i	Të ardhurat nën 70% të të ardhurave mesatare të njësisë të vetqeverisjes vendore.	7
ii	Të ardhura 70-100% të të ardhurave mesatare të njësisë të vetqeverisjes vendore.	9
iii	Të ardhura 100-120% të të ardhurave mesatare të njësisë të vetqeverisjes vendore.	9
	TOTALI PIKË	100

K R Y E T A R

Manjola KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

DREJTORIA E EMERGJENCAVE, STREHIMIT, ADMINISTRIMIT TË TOKES NJ.A,
TRANSPORTIT DHE SHERBIMEVE, SEKTORI TRAJTIMIT TE TITUJVE
TE PRONESISE DHE SHPRONESIMEVE

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më _____, 2024

RELACION

“PER MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PËRZGJEDHJEN E PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I STREHIMIT SOCIAL “SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË”.

Në zbatim të programit “Subvencionimi i Interesave të Kredisë” për familjet e pastreha, me fonde të buxhetit të shtetit, Bashkia Pogradec do të vazhdojë të zbatojë këtë program dhe për vitin 2024, deri në plotësim të kuotave të vëna në dispozicion nga MFE. Më specifikisht, programi social i strehimit për “Subvencionimin e interesave të kredisë” synon të mbështesë individë /familje në blerjen e shtëpive të para, me qëllim përmirësimin e cilësisë të jetesës. Prioritet i jepet familjeve të reja ,individë me moshë jo më shumë ose baras me 40 vjet, gra kryefamiljare apo individë /familje të minoritetit rom e egjiptian, por nuk përjashtojnë kategoritë e tjera prioritare që përcakton neni 16 i ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social”. Administrimi i kërkesave për të përfituar nga ky program dhe përzgjedhja e familjeve përfituese bëhet online nëpërmjet sistemit të pikëzimit. Në zbatim të neneve 15, 47, 47/1 të Ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social, i ndryshuar sistemi i pikëzimit ka 100 pikë në total dhe cdo kriter i përcaktuar në nenin 16 të ligjit përmban 25 pikë. Subvencionimi i interesave të kredisë ,është instrument financiar që siguron strehim social në në mungesë të programit të banesave me kosto të ulët bazuar dhe në kushtet e dhënies së kredisë sipas Marrëveshjen Dypalëshe “Për Kreditimin në Kuadër të Programit të Banesave me Kosto të Ulët për Familjet që Përfitojnë Subvencionimin e Interesave të Kredisë” nënshkruar midis palëve ,Ministrit të Financave dhe Ekonomisë me bankat e nivelit të dytë .Në zbatim dhe të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, VKM nr.384, datë 12.06.2019, “Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërës prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve, procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, VKM nr.301, datë 15.04.2020 ”Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, VKM Nr.268 datë 29.04.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr.453, datë 3.07.2019.”Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet, që përfitojnë banesë me kosto të ulët ,me kredi të lehtësuara nga shteti”, ju paraqesim sistemin e pikëzimit për trajtim sipas programit të strehimit social”Subvencionimi i interesave të Kredisë” për blerjen e banesave me kosto të ulët sipas tabelës bashkangjitur.

Konceptoi: K. Liçkollari

Pranoi: M. Ziko

Miratoi: B. Niko

Konfirmoi: D. Babasuli